

LIGJI Nr. 03/L-184

PËR ENERGJINË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR ENERGJINË

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen aktivitetet në sektorin e energjisë në Republikën Kosovës me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji për të krijuar kushte të një tregu funksional të energjisë dhe krahas kësaj duke promovuar edhe shfrytëzimin më eficient të energjisë, rritjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit si dhe përmirësime në mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaritë energjetike.

2. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin energjinë elektrike, ngrohjen, gazin natyror dhe burimet e ripërtërishme të energjisë, dhe përcakton :

2.1. zhvillimin dhe implementimin e strategjisë së energjisë, përfshirë parashikimin e balancave të energjisë dhe politikat mbi efikasitetin e energjisë, burimet e ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimin

2.2. rolet e Qeverisë së Kosovës, qeverisjes lokale dhe institucioneve tjera dhe siguron publikut mundësi për pjesëmarrje të gjerë në zhvillimin e strategjisë së energjisë dhe në implementimin e saj;

2.3. aktivitetet për rregullimin e sektorit të energjisë që kryhen nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

2.4. ngritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë;

2.5. vendosjen e detyrimeve për shërbim publik ndaj ndërmarrjeve energjetike, sipas nevojës;

2.6. nxjerrjen e legjislacionit sekondar nga Ministria në çështje të specifikuara në këtë ligj; dhe

2.7. masat që mund të merren në rast të emergjencave energjetike.

3. Me qëllim të avancimit të interesit publik përmes nxitjes së investimeve në ndërmarrjet e energjisë, ky ligj i sqaron dhe siguron të drejtat e ndërmarrjeve të energjisë mbi pronën që aktualisht është në shfrytëzim ose posedim të tyre që është e nevojshme për operimin ose mirëmbajtje e stabilimenteve ekzistuese energjetike si dhe të drejtave pronësore të cilat në të ardhmen mund të nevojiten nga ndërmarrjet e energjisë për ushtrimin e aktiviteteve energjetike.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Kodet** - rregullat që parashikohen për themelimin e dizajnit minimal teknik, kushtet dhe standardet operative, dhe kushtet komerciale për aktivitetet përkatëse në sektorin e energjisë, për të cilat ligji kërkon që t'i dorëzohen për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji;

1.2. **Bashkë-prodhimi** - procesi teknologjik i cili përfshinë prodhimin e njëkohshëm të ngrohjes së dobishme dhe energjisë elektrike për konsumim nga prodhuesi apo për shitje;

1.3. **Konsumator** - konsumatorin me shumicë, konsumatorin fundor të energjisë;

1.4. **Shpërndarja** - transportin e energjisë elektrike, gazit natyror apo ngrohjes në linjat e sistemit të shpërndarjes, apo në sisteme apo tubacione lokale apo rajonale, me synim të dërgimit dhe shitjes të konsumatorët duke mos përfshirë furnizimin.

1.5. **Operatori i sistemit të shpërndarjes** - personat fizikë apo juridikë që kryejnë shpërndarjen dhe që janë përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, dhe në raste të caktuara, ndërlidhjen e këtij sistemi me sisteme tjera, dhe janë përgjegjës për të siguruar që sistemi në aspekt afatgjatë të jetë në gjendje të përmbush nevojat e arsyeshme sa i përket shpërndarjes së energjisë elektrike, ngrohjes apo gazit natyral;

1.6. **Energjia elektrike** - forma e energjisë e cila transportohet në formë të rrymës përmes përcuesve metalikë, me qëllim të shitjes së saj tek konsumatorët;

1.7. **Energjia** - çdo formë e prodhuar ose e përfitur e energjisë (energji elektrike, energji e ngrohjes dhe gazi natyror) me qëllim të furnizimit ose të shitjes;

1.8. **Aktivitetet energjetike** - realizimin e një apo më shumë veprimtarive të prodhimit, bartjes, shpërndarjes, furnizimit apo depozitimit të energjisë;

1.9. **Efiqenca e energjisë** - raportin mes vlerës së prodhimit sa i përket performancës, shërbimit, mallrave apo energjisë, dhe vlerës së sasisë së energjisë;

1.10. **Ndërmarrja e energjisë** - një person ose ndërmarrje që ligjërisht ushtron një ose më shumë aktivitete të energjisë dhe është përgjegjëse për detyrat komerciale, teknike dhe/ose të mirëmbajtjes që kanë të bëjnë me ato aktivitete (por pa përfshirë konsumatorët e fundit);

1.11. **Stabilimentet energjetike** - të gjitha instalimet, ndërtesat, objektet, duke përfshirë objektet ndihmëse ose të ndërlidhura, sistemet dhe pajisjet, duke përfshirë shtyllat, shtyllat e tensionit të lartë, linjat e transmisionit ose shpërndarjes pavarësisht nëse janë mbi ose nën tokë që shfrytëzohen nga një ndërmarrje e energjisë për ushtrimin e aktiviteteve të saj energjetike ose që janë pjesë e një centrali prodhues, sistemit të transmisionit ose sistemi të shpërndarjes ose që janë pjesë e pajisjeve që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me pajisjet e konsumatorit, ose interkonektorët ose linjat direkte ose (vetëm për qëllime të neneve 25 deri 28 të këtij ligji) në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfrytëzohen nga një ndërmarrje e energjisë për ushtrimin e aktiviteteve të saj minerare në bazë të të drejtave të ndërmarrjes energjetike sipas licencës ose lejes përkatëse për ushtrimin e këtyre aktiviteteve minerare.

1.12. **Zyra e Rregullatorit për Energji** - rregullatorin e pavarur të aktiviteteve energjetike, me kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Rregullatorit për Energji, në këtë ligj dhe në ligjet tjera, që rregullojnë ushtrimin e aktiviteteve energjetike;

- 1.13. **Sektori i energjisë** - aktivitetet të cilat përfshijnë prodhimin, shpërndarjen, bartjen, depozitim, shitjen, rishitjen, blerjen dhe furnizimin e energjisë;
- 1.14. **Konsumatori fundor** - konsumatorin i cili blen energjinë për nevoja të veta;
- 1.15. **Prodhimi** - prodhimin e energjisë elektrike apo energjisë së ngrohjes me qëllim të konsumit apo shitjes së saj;
- 1.16. **Cak i energjisë së ripërtërishme** - sasinë e parashikuar të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë ose bashkë-prodhimi;
- 1.17. **Licenca** - dokumentin e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, që i mundëson bartësit të licencës të ushtrojë aktivitete në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë;
- 1.18. **Planifikimi afatgjatë** - planifikimi i nevojave për investime në kapacitetet e prodhimit, transmissioinit dhe shpërndarjes, për një periudhë afatgjate, me qëllim të plotësimit të kërkesës së sistemit për energji elektrike, energji të ngrohjes ose gaz natyror në Kosovë, sigurimit të diversifikimit të burimeve dhe sigurimit të furnizimit për konsumatorë;
- 1.19. **Pajisjet e matjes** - instrumentet e regjistruara në regjistrin për pajisjet matëse të certifikuar në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar;
- 1.20. **Ministria** - Ministria e Republikës së Kosovës përgjegjëse për sektorin e energjisë;
- 1.21. **Gazi natyror** - përzierje e kompozimeve karbohidrate që ekzistojnë në gjendje të gaztë, apo soluciojn me naftën e përpunuar në rezervuarët natyrorë nëntokësor. Karbohidratet parësore që zakonisht gjenden në përzierje janë metani, etani, propane, butani dhe petanet.
- 1.22. **Entitet paraardhës** - një entitet në pronësi publike ose shoqërore i cili ka ofruar shërbime për sektorin e energjisë elektrike në Kosovë para datës 22 Dhjetor 2005. Ministria e Ekonomisë dhe Financave është përgjegjëse për identifikimin dhe nxjerrjen e një liste të këtyre entiteteve.
- 1.23. **Prodhuesi** - personi fizik apo juridik që prodhon energji elektrike ose ngrohje;
- 1.24. **Tokë publike** - toka që është në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Republikës së Kosovës ose një Komune (siç është përkufizuar ky term në Ligjin për Vetë Qeverisjen Lokale).
- 1.25. **Obligimi për shërbim publik** - detyra që i besohet ndërmarrjes energjetike sa i përket ofrimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, që mund të ndërlihdhen me sigurinë e furnizimit, rregullsinë, cilësinë dhe çmimet e furnizimit dhe mbrojtjen e mjedisit, dhe të cilat marrin parasysh faktorët e përgjithshëm socialë, ekonomikë dhe mjedisorë;
- 1.26. **Burimet e ripërtërishme të energjisë** - burimet e ripërtërishme jo-fosile të energjisë, siç janë: era, energjia diellore, ujërat gjeotermale, energjia valore, energjia e ujit, bio-energjia, bio-masa dhe bio-gazet;
- 1.27. **Siguria e furnizimit të energjisë** - aftësinë e sistemeve të energjisë për të furnizuar konsumatorët e fundit me sasi adekuate të energjisë për t'i përmbushur nevojat e tyre;
- 1.28. **Furnizimi** - shitjen, përfshirë edhe rishitjen, e energjisë tek konsumatorët;
- 1.29. **Tarifa** - çmimin apo një grup çmimesh për energji, për përdorim të sistemeve të energjisë ose për shërbime tjera të ndërlihdhura me energjinë;
- 1.30. **Metodologjia tarifore** - rregullat, metodat dhe parimet që përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji për t'u zbatuar në vendosjen tarifave të rregulluara;

1.31. **Transmisioni -bartja** - transmetimin e energjisë elektrike, bartjen e ngrohjes ose gazit natyror, përkatësisht, në rrjetet e tensionit të lartë, në rrjete ose tubacione me shtypje të lartë (përveç tubacioneve me rrjedhë të sipërme), me qëllim të dërgimit të konsumatorët e fundit, duke mos përfshirë furnizimin;

1.32. **Operatori i Sistemit të Transmisionit** - personat fizikë dhe juridikë përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të transmisionit në një zonë të caktuar, dhe në raste të caktuara ndërlidhjen e tij me sistemet tjera, dhe për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transmision të energjisë elektrike, ngrohjes apo gazit natyral.

1.33. **Konsumatori me shumicë** – personi fizik ose juridik (përveç operatorëve të sistemit të transmisionit dhe sistemit të shpërndarjes në rastin e gazit natyror) i cili blen energji me qëllim të rishitjes brenda ose jashtë sistemit ku ai është i themeluar;

2. Termet tjerë të përdorur në këtë ligj, por që nuk janë përkufizuar në këtë ligj, do të kenë domethënien e cekur në Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Gazin Natyror, Ligjin për Ngrohjen Qendrore apo në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

KREU II **STRATEGJIA E ENERGJISË, PROGRAMI I ZBATIMIT DHE BALANCET E ENERGJISË**

Neni 3 **Strategjia e Energjisë**

1. Strategjia e Energjisë është dokumenti themelor që përcakton politikat e energjisë dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë, në përputhje me Strategjinë e Përgjithshme Zhvillimore të Republikës së Kosovës.

2. Strategjia e Energjisë hartohet nga Ministria në pajtim me paragrafët 3., 4., 5. dhe 6. të këtij neni. Strategjia e Energjisë mund të përfshijë synimet zhvillimore për sektorët e energjisë sipas nevojës. Ministria do të sigurojë se përgatitja e Strategjisë së Energjisë do të kryhet në koordinim me zhvillimet tjera relevante politike, si brenda Ministrisë ashtu edhe brenda Qeverisë së Kosovës.

3. Strategjia e Energjisë do t'i dorëzohet Qeverisë së Republikës së Kosovës nga Ministria për shqyrtim dhe miratim. Pas shqyrtimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

4. Ministria, në intervale kohore prej jo më shumë se tri (3) vite, kryen rishikimin e Strategjisë së Energjisë dhe përgatit Strategjinë e Energjisë në pajtim me procedurat e përshkruara në dispozitat e këtij neni. Të gjitha modifikimet e propozuara për Strategjinë e Energjisë duhet të parashtrohen për miratim në Kuvend.

5. Gjatë hartimit të Strategjisë së Energjisë, Ministria duhet të konsultohet me Zyrën e Rregullatorit për Energjisë, operatorët e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike, ngrohjes dhe gazit natyror dhe subjektet tjera të licencuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, përfaqësuesit e konsumatorëve si dhe me autoritetet tjera publike relevante në Kosovë. Pas përfundimit të Draft Strategjisë së Energjisë, Ministria, duke u siguruar konfidencialitetin e informatave përkatëse, do ta nxjerrë draftin në diskutim publik për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditëve. Pas shqyrtimit të të gjitha komenteve, sugjerimeve, propozimeve, etj., si dhe pas inkorporimit përkatës të tyre, Ministria dërgon draft Strategjinë e Energjisë te Qeveria e Republikës së Kosovës.

6. Strategjia e Energjisë hartohet për një periudhë dhjetë (10) vjeçare duke marrë parasysh rrethanat zhvillimore në Kosovë dhe ka për qëllim të;

6.1. promovojë siguri të furnizimit të energjisë brenda një sektori të sigurt dhe të qëndrueshëm të energjisë, përfshirë promovimin e shumëllojshëm të burimeve;

- 6.2. sigurojë balancën adekuate afatgjate ndërmjet furnizimit dhe kërkesës për energji në zhvillimin afatgjatë të sektorit të energjisë, duke marrë parasysh parashikimet e kërkesave për energji si dhe diversifikimin e burimeve të energjisë;
- 6.3. shfrytëzojë në mënyrë të arsyeshme burimet vendore të energjisë sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
- 6.4. mundësojë vazhdimësi të furnizimit të energjisë, përmes kombinimit të niveleve adekuate të kapaciteteve të prodhimit në dispozicion dhe kapaciteteve të mjaftueshme të transmissioinit dhe shpërndarjes në Kosovë si dhe me interkoneksionet me sistemet tjera;
- 6.5. nxisë fleksibilitet në kontraktimin e energjisë dhe shfrytëzimin e energjisë, për shembull, përmes largimit të barrierave të cilat parandalojnë përdorimin e kontratave të pandërprera apo të cilat parandalojnë përmylljen e kontratave të kohëzgjatjeve të ndryshueshme për prodhues dhe konsumatorë;
- 6.6. sigurojë shfrytëzimin optimal të burimeve të ripërtërishme të energjisë në pajtim me caqet e parashtruara sa i përket energjisë së ripërtërishme;
- 6.7. përmirësojë eficiencën e energjisë dhe të nxisë masa të ruajtjes së energjisë, në konsistencë me caqet e energjisë së ripërtërishme;
- 6.8. inkurajojë miratimin e teknologjive të menaxhimit të kërkesës në kohë reale, siç janë sistemet e avancuara të matjes;
- 6.9. mbrojë interesat e konsumatorëve të energjisë, veçanërisht të konsumatorëve të cenueshëm;
- 6.10. sigurojë disponueshmerinë e shërbimit universal dhe mundësinë e zgjidhjes së furnizuesit të energjisë për konsumatorët e fundit në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike;
- 6.11. sigurojë mjedis të qëndrueshëm gjatë kryerjes së aktiviteteve të energjisë;
- 6.12. promovojë investimet në sektorin e energjisë;
- 6.13. promovojë konkurrencën në sektorin e energjisë bazuar në parimet e jo-diskriminimit dhe transparencës, përfshirë zhvillimin e tregjeve aktive të shitjes me shumicë të energjisë brenda Kosovës;
- 6.14. mundësojë një nivel të duhur të bashkëpunimit me shtetet fqinje, për lidhjen e sistemit të energjisë së Kosovës ose pjesëve të tij, me sistemin e energjisë të Evropës ose me sistemet e vendeve të tjera, dhe për integrimin e tregjeve rajonale të energjisë, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet e lidhjeve të tilla.
7. Ministria, sipas nevojës, përgatit dokumente që përmbajnë qëndrime dhe udhëzime mbi të gjitha çështjet që janë në pajtim me rolin e Ministrisë në përkufizimin e politikave të energjisë
8. Të gjitha dokumentet që përmbajnë qëndrime dhe udhëzime të përgatitura nga Ministria do t'i nënshtrohen kërkesave të njëjta për konsultime publike sikurse Strategjia e Energjisë, por ato nuk i dorëzohen Qeverisë së Republikës së Kosovës por mund të nxirren drejtpërsëdrejti nga Ministria.

Neni 4

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë

1. Bazuar në Strategjinë e Energjisë, Ministria përgatit dhe Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Programin për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë për një periudhë së paku trevjeçare. Ministria do të jetë përgjegjëse për zbatimin e Programit të Strategjisë së Energjisë.
2. Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë përcakton masat, programet dhe aktivitetet që duhen zbatuar, përfshirë parashikimin e shpenzimeve dhe burimet e pritura të financimit, afatet kohore për

implementim, subjektet përgjegjëse për implementimin e të gjitha aktiviteteve dhe aranzhimet monitoruese dhe raportuese mbi progresin.

3. Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë, specifikon bashkëpunimin e nevojshëm me organet dhe institucionet e qeverive lokale në lëmin e planifikimit të sektorit të energjisë, si dhe bashkëpunimin e nevojshëm me ndërmarrjet e energjisë dhe organizatat ndërkombëtare.

4. Për zbatimin e detyrave që kanë të bëjnë me Strategjinë e Energjisë, Qeveria mund të miratojë legjislacion sekondar për themelimin, financimin dhe operimin e Zyrrave Komunale të Energjisë, në rast se kjo është e domosdoshme për të adresuar çështjet e implementimit dhe monitorimit në nivel lokal.

5. Ministrinë dhe institucionet tjera të Qeverisë, përfshirë organet e qeverive lokale, do ta këshillojnë dhe ndihmojnë Ministrinë në implementimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, deri në masë që është në pajtim me detyrat dhe autorizimet e tyre.

6. Ndërmarrja energjetike dhe personat tjerë do të jenë të obliguar t'i përmbahen politikave dhe obligimeve që rrjedhin nga Strategjia e Energjisë dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, deri në masën e përcaktuar në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë. Në rastet kur pajtueshmëria me këto politika apo obligime ka të ngjarë të rezultojë me kosto shtesë që mbulohen nga ndërmarrjet energjetike, Ministria, në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit për Energji, bën aranzhime për të siguruar që:

6.1. këto shpenzime shtesë të imponohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, dhe që

6.2. ndërmarrjet energjetike të jenë në gjendje t'i mbulojnë këto shpenzime të arsyeshme shtesë, përmes mjeteve tjera dhe detyrimeve tek konsumatorët.

7. Ministria paraqet raportin vjetor para Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi progresin në realizimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë. Të gjithë raportet përfshijnë hollësi mbi përparimin përkatës në zbatimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, në periudhën e mbuluar nga raporti, dhe do t'i theksojnë zhvillimet që priten në periudhën e mbetur të Programit.

Neni 5 Balanca Kombëtare e Energjisë

1. Ministria miraton parashikimin e balancës afatgjate dhe vjetore të energjisë si dhe e publikon atë, në pajtim me dispozitat e këtij neni. Në balancën e energjisë paraqitet parashikimi për kërkesën totale për energji dhe përbërjen e saj, llojet e burimeve të energjisë që priten të jenë në dispozicion, si dhe masat zbatuese për përmbushjen e kërkesës me energji. Balanca afatgjate dhe vjetore e energjisë elektrike i propozohet Ministrisë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, pas konsultimeve me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit e licencuar.

2. Balanca afatgjate e energjisë është parashikim i një periudhe dhjetë (10) vjeçare dhe miratohet nga Ministria, e cila atë e publikon jo më vonë se më datën 1 dhjetor për çdo dy (2) vite. Parashikimet e balancave vjetore të energjisë miratohen dhe publikohen së paku një (1) muaj para fillimit të vitit të cilit i përkasin. Balanca vjetore e energjisë për vitin paraprak do të miratohet dhe publikohet brenda gjashtë (6) muajve të parë të vitit vijues.

3. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të konsultohet me Zyrën e Rregullatorit për Energji, sa i përket planifikimit të parashikimeve të nevojshme të balancave të energjisë, dhe do të merr parasysh këto konsultime gjatë përgatitjes së propozimeve për metodologjinë. Ky propozim do të dorëzohet për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Shumë shpejt pas pranimit të këtij propozimi, Zyra e Rregullatorit të Energjisë i dërgon Ministrisë së kopje të propozimit dhe ministria ka njëzet (20) ditë në dispozicion për dërgimin e komenteve të saj mbi propozimin në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të marrë parasysh të gjitha komenteve e pranuar me kohë nga Ministria gjatë marrjes së vendimit të saj mbi pranimin apo jo të propozimit. Ky vendim duhet të nxirret nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë jo më shumë se dyzetepesë (45) ditë pas pranimit të propozimit.

4. Zyra e Rregullatorit të Energjisë nxjerr metodologjinë e miratuar që duhet zbatuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në metodologjinë e parashikimit dhe proceset e grumbullimit të të dhënave për sajimin e balancës së energjisë.

Neni 6 **Roli i qeverisjes lokale**

1. Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë e Energjisë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe balanceve të energjisë.

2. Përveç atyre që theksohen në paragrafin 1. të këtij neni, të këtij neni organet e qeverisjes lokale duhet të bashkëpunojnë edhe me Ministrinë, Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes në lidhje me të drejtën për qasje në tokë ku duhet të vendosen pajisjet dhe stabilimentet energjetike.

Neni 7 **Planet Zhvillimore të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit dhe Shpërndarjes**

1. Operatorët e Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes përgatisin dhe publikojnë planet zhvillimore afatmesme dhe afatgjata në pajtim me kërkesat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Këto plane zhvillimore duhet të jenë në pajtim me obligimet e tyre sipas licencave dhe në pajtueshmëri me Strategjinë e Energjisë, Programin e Zbatimit të Strategjisë dhe balancat e energjisë.

2. Planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes njohin:

2.1. rëndësinë e mirëmbajtjes së rregullt dhe, sipas nevojës, rinovimin e rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes si elemente zhvillimore, për mirëmbajtjen e performancës së rrjeteve;

2.2. rëndësinë e të siguruarit të këmbimit të informatave në mes veti si dhe me operatorët e tjerë të sistemit, si në Kosovë ashtu dhe sistemet tjera, mbi veprimtarinë e rrjetit, në kohë të duhur dhe në baza efektive;

2.3. nevojën për të përmbushur të gjithë objektivat e performancës që kanë të bëjnë sistemet e tyre të cilët vendosen në pajtim me licencat e tyre apo rregullat apo kodet tjera;

2.4. nevojën për të siguruar kapacitet të mjaftueshëm rezervë në sistemin e transmisionit që akomodon prodhim stabil për operim të qëndrueshëm të sistemi;

2.5. në rastin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, nevojën për të ndërmarrë hapa në avancimin e shfrytëzimit të kapaciteteve rezervë të prodhimit për të ngritur besueshmërinë e furnizimit, gjithnjë në pajtueshmëri me kërkesat që dalin nga kodet e aplikueshme;

2.6. nevojën për shfrytëzimin sa më të efektshëm të interkonektorëve ekzistues; dhe

2.7. dëshirën për të siguruar nivel më të lartë të interkoneksionit me sistemet energjetike të Evropës në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i tregut rajonal të energjisë, duke marrë parasysh kostot e ndërtimit të interkoneksioneve të reja krahas përfitimeve për konsumatorët.

3. Të gjithë planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e sistemit të transmisionit apo shpërndarjes duhet të dorëzohen në Ministri për rishikim. Ministria shqyrton planet e tilla zhvillimore dhe mund të publikojë një mendim në lidhje me nivelin e pajtueshmërisë së atij plani me Strategjinë e Energjisë, Programin e Zbatimit të Strategjisë dhe Balancës së Energjisë, dhe ligjin. Të gjitha parashtrimet e tilla apo mendimet e publikuara nuk do të ndikojnë në termat kohor dhe nuk do të zvogëlojnë apo ndryshojnë obligimet e operatorëve të sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes për dorëzimin e planeve të tilla në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

KREU III

EFIÇIENCA E ENERGISË, BURIMET E RIPËRTËRISHME DHE BASHKËPRODHIMI

Neni 8

Politika e efiçencës së energjisë

1. Politika e efiçencës së energjisë është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë dhe fushëveprimi dhe përmbajtja e saj duhet të jetë në harmoni me detyrimet e Kosovës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionit përkatës.

2. Qëllimi i politikës së efiçencës së energjisë është përmirësimi i efiçencës së energjisë dhe shfrytëzimi i potencialeve kursyese të energjisë me qëllim të arritjes së nivelit optimal të efiçencës së energjisë në Kosovë.

Neni 9

Zbatimi i politikës së efiçencës së energjisë

1. Për zbatimin e politikës së efiçencës së energjisë, Ministria duhet të:

1.1. harton planin dhjetë (10) vjeçar dhe tre (3) vjeçar të veprimit për zhvillim të efiçencës së energjisë, në përputhje me detyrimet e Kosovës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, përfshirë cakun dhjetë (10) vjeçar për kursim të energjisë;

1.2. mbikëqyr zbatimin e planeve të veprimit për zhvillim të efiçencës së energjisë dhe përmbushjen e caqeve të specifikuar të kursimit të energjisë;

1.3. përkujdeset për përmirësime në nivelin e efiçencës së energjisë në ndërtesa dhe rregullimet për certifikimin energjetik të ndërtesave;

1.4. nxitë procesin e auditimit të energjisë, si dhe planet zhvillimore komunale për efiçencën e energjisë;

1.5. publikon të dhëna lidhur me nivelet dhe zhvillimet e efiçencës së energjisë;

1.6. përgatitë dhe miraton akte nënligjore për promovimin e shfrytëzimin efikas të energjisë, pas konsultimit me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe organin publik të cilit i është dhënë përgjegjësia kryesore me ligj për çështjet që kanë të bëjnë me efiçencën e energjisë;

1.7. nxitë organizatat joqeveritare të veprojnë në sektorin e energjisë në mënyrë që të ndikojnë në kursimin e energjisë;

2. Organi publik të cilit i është dhënë përgjegjësia kryesore për çështjet e efiçencës së energjisë me ligj do të ngarkohet me zbatimin e politikave të efiçencës së energjisë në përputhje me Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë. Organizimi, financimi dhe detyrat e këtij organi publik do të përcaktohen në një ligj të veçantë i cili rregullon çështjet e efiçencës së energjisë.

Neni 10

Politika për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë dhe Bashkëprodhimin

1. Qëllimi i politikës së burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit është nxitja e shfrytëzimit ekonomik dhe të qëndrueshëm të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit, me qëllim të përmbushjes së niveleve të caktuara të përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit në Kosovë.

2. Politika e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit është pjesë përbërëse e Strategjisë së Kosovës të Energjisë.

Neni 11

Zbatimi i politikës së burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit

1. Për zbatimin e politikës së burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit, Ministria:

1.1. harton planin afatmesëm dhe afatgjatë të veprimit për burime të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimin që janë në përputhje me detyrimet e Kosovës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

1.2. mbikëqyr zbatimin e politikës për burimet e ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit;

1.3. përcakton caqet e energjisë së ripërtërishme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit.

Neni 12

Detyrimet e ndërmarrjeve energjetike lidhur me burimet e ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimin

1. Gjatë dispeçimit të energjisë së prodhuar, Operatori i Sistemit të Transmisionit, ose operatori i sistemit të shpërndarjes, sipas nevojës, duhet t'i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimi, sipas limiteve të specifikuara për qëllime të sigurimit të sistemit në Kodin e rrejtit dhe në rregullat e kodet tjera;

2. Operatorët e sistemit të transmisionit- dhe shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi bartësin e shpenzimeve të adoptimeve teknike, siç janë kyçjet në rrjet dhe përforcimet e rrjeteve të tyre, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike që furnizojnë me energji elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë në sistemin e ndërlidhur. Këto rregulla dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Kosovës dhe të bazohen në kritere objektive, transparente e jo-diskriminuese, veçanërisht duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që dalin nga kyçja e këtyre prodhuesve me sistemin;

3. Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike që përdorë burime të ripërtërishme të energjisë apo bashkëprodhim e që dëshiron të lidhet në sistem, vlerësimin e plotë e të hollësishëm lidhur me shpenzimet që krijohen nga kyçja, për të cilin vlerësim operatori i sistemit mund të ngarkojë një pagesë e cila pasqyron kostot e arsyeshme të tij .

4. Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve për instalimin e sistemeve siç janë kyçje në rrjet dhe përforcimet ndërmjet të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike,që përfitojnë prej tyre. Këto rregulla, parashtrohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, si dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e energjisë, si dhe me aktet e tjera nënligjore, rregullave apo kodeve;

5. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që tarifat e transmisionit dhe të shpërndarjes për kyçje dhe shfrytëzim të sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes të mos diskriminojnë energjinë elektrike me prejardhje nga burimet e ripërtërishme të energjisë, e posaçërisht energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë në rajonet periferike dhe me dendësi të vogël të popullatës.

Neni 13

Caqet e energjisë së ripërtërishme

1. Ministria duhet të përcaktoj caqet vjetore dhe afatgjate për burimet e ripërtërishme të energjisë për konsumin e energjisë elektrike dhe energjisë së ngrohjes të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe/ose bashkëprodhimit.

2. Caqet afatgjate të energjisë së ripërtërishme hartohen për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, në pajtim me metodologjinë e përcaktuar me legjislacion sekondar, të nxjerrë nga Ministria:

3. Ministria përgatit dhe nxjerrë akte nënligjore që përfshijnë masat që synojnë përmbushjen e caqeve të energjisë së ripërtërishme, dhe të gjitha propozimet e tilla marrin parasysh si në vijim;

3.1. parimet e tregut konkurrues të energjisë dhe

3.2. karakteristikat e llojeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.

4. Ministria do të hartoj dhe publikoj raportin mbi realizimin e caqeve vjetore afatgjatë për burimet e ripërtërishme të energjisë si pjesë e raportit mbi Implementimin e Programit për Strategjinë e Energjisë në neni 4 paragrafi 7. të këtij ligji. Raporti duhet të përfshijë një analizë të progresit për realizimin e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë, veçanërisht duke marrë për bazë ndikimin e faktorëve klimatikë. Kjo analizë gjithashtu do të tregoj/paraqes shtrirjen e masave për realizimin e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.

5. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji certifikon prejardhjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE sipas kritereve objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

KREU IV INVESTIMET

Neni 14

Promovimi i investimeve në sektorin e Energjisë

1. Ndërtimi i impianteve dhe pajisjeve të reja energjetike si dhe mirëmbajtja e shfrytëzimi i tyre duhet të inkurajohet, me kusht që veprimet e tilla të jenë në përputhshmëri me detyrimet e Kosovës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm.

2. Duhet të inkurajohen investimet private në sektorin e energjisë në Kosovë dhe të krijohet një mjedis i favorshëm për investime huaja, përfshirë kushtet për treg të hapur për prodhimin dhe blerjen e materialeve të energjisë me qëllim të tërheqjes së investimeve të çfarëdo lloji, si për ndërtimin e impianteve të reja energjetike ashtu edhe për modernizimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, e po ashtu edhe sistemeve të transmisionit dhe sistemeve të shpërndarjes.

3. Aty ku planifikohen investime në njësi të reja prodhuese me kapacitet mbi pesëdhjetë megavat (50MW) apo më shumë, investitori duhet t'i paraqesë Ministrisë një analizë mbi potencialin e zbatimit të bashkëprodhimit në një investim të tillë. Analiza duhet të jetë kryer nga një ekspert i pavarur, të bazohet në të dhëna të dokumentuara shkencore, të jetë në pajtim me kërkesat e Direktivës së Komunitetit Evropian 2004/8/EC, promovimit të bashkëprodhimit duke u bazuar në parashikimin e kërkesës për ngrohje të dobishme në tregun e brendshëm të energjisë.

4. Nëse analiza e parashikuar me paragrafin 3. të këtij neni tregon që bashkëprodhimi mund të zbatohet në investim pa ndikim negativ në profitabilitetin e investimit, Ministria, në pajtim me qëllimin e identifikuar në paragrafin 3. të këtij neni për të krijuar një mjedis të favorshëm për investime, mund të kërkojë që bashkëprodhimi të konsiderohet si komponentë e investimit.

KREU V RREGULLIMI EKONOMIK I AKTIVITETEVE ENERGJETIKE

Neni 15

Rregullimi i aktiviteteve energjetike

1. Rregullimi ekonomik i aktiviteteve në sektorin e energjisë zbatohet në përputhshmëri me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, në mënyrë që të përcaktohet një kornizë transparente dhe rregullative e cila do të:

- 1.1. përkrahë një mjedis të qëndrueshëm për investime në sektorin e energjisë;
- 1.2. sigurojë kornizë të duhur për zhvillimin e konkurrencës, duke përfshirë sigurimin e kushteve transparente dhe jo-diskriminuese të qasjes në sistemet e transmisionit dhe shpërndarjes;
- 1.3. të përmirësoj sigurinë e furnizimit me energji; dhe
- 1.4. mbrojë interesat e konsumatorëve, duke përfshirë ofrimin e mbrojtjes për konsumatorët e cenueshëm.

2. Detyrat e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë përfshijnë monitorimin e sigurimit të furnizimit të energjisë dhe kryhen në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

3. Aktivitetet energjetike në sektorin e energjisë ushtrohen në bazë të licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, përveç për ato aktivitete të cilat janë liruar nga kërkesa për marrjen e licencës, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 16 Llojet e aktiviteteve rregullative

1. Aktivitetet energjetike ushtrohen në bazë të rregullave që i rregullojnë ato si aktivitete konkurruese, të bazuara në treg ose si aktivitete jo-konkurruese për të cilat tarifat dhe kushtet tjera i nënshtrohen rregullimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

2. Të gjitha ndërmarrjet e energjisë i shërbejnë interesit të konsumatorëve individualë duke siguruar furnizim të sigurt, efikas dhe të qëndrueshëm me energji elektrike, energji për ngrohje apo gaz natyror kualitativ, duke siguruar shfrytëzim me efikasitet të burimeve të energjisë njëkohësisht duke respektuar mbrojtjen e ambientit, shëndetit, jetës dhe pronës së popullit të Kosovës.

3. Zyra e Rregullatorit për Energji mund t'i vejë ndërmarrjeve obligime specifike të shërbimit publik të cilat lidhen me sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit të energjisë, rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimit, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto obligime do të definohen në mënyrë të qartë, do të jenë transparente, jo diskriminuese dhe të verifikueshme si dhe do të garantojnë qasje të barabartë nga ndërmarrjet e energjisë nga palët e Komunitetit të Energjisë.

4. Kostot dhe shpenzimet e bëra nga ndërmarrjet energjetike në lidhje me paragrafin 3. të këtij neni, pas shqyrtimit me Zyrën e Rregullatorit për Energji për të siguruar arsyeshmërinë e tyre, njihen si tarifa dhe shpenzime të arsyetuara për qëllime të vendosjes së tarifave. Kompensimi për këto kosto nuk duhet të tejkalojë kostot e bëra në ushtrimin e detyrimeve të shërbimeve publike minus të ardhurat e fituara nga ofrimi i shërbimit. Kompensimi mund të përfshijë një fitim të arsyeshëm.

Neni 17 Rregullimi i tarifave të sektorit të energjisë

Siç është përcaktuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, të gjitha tarifat e rregulluara dhe metodologjitë tarifore duhet t'i mundësojnë ndërmarrjes së rregulluar të energjisë mundësinë që të ngarkojë me tarifa dhe të kthejë koston e arsyeshme të plotë vjetore për shërbime.

Neni 18 Informatat konfidenciale

1. Ndërmarrjet e energjisë që ushtrojnë aktivitete në fushën e energjisë elektrike, energjisë së ngrohjes, apo gazit natyror janë të obliguara të ruajnë informatat e fshehta të përvetësuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe kryerjes së detyrave të tyre sipas këtij ligji, përveç nëse me ligje të tjera kërkohet që informatat e tilla të publikohen ose t'u vihen në dispozicion organeve qeveritare të specifikuar në ato ligje.

2. Përcaktimi se cilat informata janë konfidenciale bëhet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe rregullat e nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

3. Duke mos paragjykuar paragrafin në paragrafin 1 të këtij neni, Zyra e Rregullatorit për Energji, apo Ministria mund t'u kërkojnë ndërmarrjeve të energjisë që Zyrës së Rregullatorit të Energjisë apo Ministrisë t'i sigurojë informata të fshehta që u nevojiten për kryerjen e funksioneve, autoritetit dhe detyrave të tyre. Nëse informatat e tilla sigurohen për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë apo Ministrinë, si dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë apo Ministria konsiderojnë se informatat janë të regjistruara apo e fshehtë me ligj, ato informata mbrohen si fshehtësi nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë apo Ministria dhe nuk i nënshtrohen ligjeve mbi shpalosjen publike.

KREU VI KONKURRENCA NË AKTIVITETET E ENERGJISË

Neni 19 Ndalimi i kufizimeve mbi konkurrencën

1. Ndërmarrjet e energjisë janë rreptësisht të ndaluara që të lidhin, marrin pjesë ose të marrin çfarëdo veprimi i cili ka për qëllim avancimin e një: marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve, një vendim të një asociacioni të ndërmarrjeve dhe/ose praktika të bashkërenduara nëse kjo marrëveshje, vendim apo praktikë ka për qëllim apo efekt parandalimin, kufizimin apo çrregullimin e konkurrencës.

2. Ndalesa e përcaktuar në paragrafin 1 zbatohet posaçërisht për marrëveshjet, vendimet ose praktikatat:

2.1. të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë rregullojnë çmimet e shitjes ose blerjes ose kushtet e tjera të tregtimit;

2.2. për kufizimin ose kontrollimin e prodhimit, tregjeve, zhvillimit teknik ose investimeve;

2.3. për ndarjen e tregjeve ose burimeve të furnizimit;

2.4. për zbatimin e kushteve të ndryshme në transaksione ekuivalente me palë të tjera tregtuese, duke i vendosur këto palë në disavantazh konkurrues;

2.5. kushtëzimin e përmbylljes së kontratave me pranimin nga palët tjera të obligimeve shtesë të cilat për nga natyra e tyre ose përdorimi komercial nuk kanë lidhje me lëndën e këtyre kontratave.

3. Të gjitha marrëveshjet dhe vendimet e ndaluara sipas këtij neni janë automatikisht të pavlefshme.

4. Në përputhje me Ligjin për Konkurrencën, dispozitat e paragrafit 1. mund të shpallen të pazbatueshme për një:

4.1. marrëveshje ose kategori të marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve;

4.2. një vendim ose kategori të vendimeve nga asociacionet e ndërmarrjeve;

4.3. një praktikë të bashkërenduar ose kategori të praktikave të bashkërenduara, që kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjes së mallrave ose në nxitjen e zhvillimit teknik ose ekonomik dhe që njëkohësisht i jep konsumatorëve një pjesë të drejtë të përfitimeve, dhe që:

4.3.1. nuk vendos mbi ndërmarrjet përkatëse kufizime të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;

4.3.2. nuk u jep këtyre ndërmarrjeve mundësinë e eliminimit të konkurrencës sa i përket një pjese të konsiderueshme të produkteve të fjalë.

Neni 20 Ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese

1. Keqpërdorimi nga një ose më shumë ndërmarrje të energjisë i pozitës dominuese është i ndaluar.
2. Keqpërdorimi i pozitës dominuese sipas paragrafit 1. të këtij neni në veçanti përfshin:
 - 2.1. vendosjen e çmimeve të paarsyeshme të shitjes ose blerjes ose kushteve të tjera të tregtimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
 - 2.2. kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik që i dëmton konsumatorët;
 - 2.3. zbatimin i kushteve të ndryshme në transaksione ekuivalente me palë të tjera tregtuese, duke i vendosur këto palë në disavantazh konkurrues;
 - 2.4. kushtëzimin e përmbylljes së kontratave me pranimin nga palët tjera të obligimeve shtesë të cilat për nga natyra e tyre ose përdorimi komercial nuk kanë lidhje me lëndën e këtyre kontratave.

Neni 21

Kompetencat e organeve rregullatore lidhur me çështjet e konkurrencës

1. Zyra e Rregullatorit për Energji në kuadër të kompetencave të saj sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, do të zbatojë masa të cilat kanë për qëllim parandalimin e shkeljeve të nenit 19 dhe 20 të këtij ligji.
2. Nëse ZRE mbledh dëshmi të arsyeshme mbi një shkelje aktuale ose të suspenduar të nenit 19 ose 20 të këtij ligji nga një ndërmarrje e energjisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë i dorëzon këto dëshmi në Komisionin Kosovar të Konkurrencës. Komisioni Kosovar i Konkurrencës inicion një hetim të shkeljes së pohuar dhe do të marrë çfarëdo masa zbatuese të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për korrigjimin ose adresimin e shkeljes së pohuar në përputhje me Ligjin për Konkurrencën.
3. Kurdo që Komisioni Kosovar i Konkurrencës kryen një hetim, qoftë në bazë të informatave të marra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë ose nga çfarëdo burimi tjetër, mbi një shkelje të pohuar ose potenciale nga një ndërmarrje e energjisë të Ligjit për Konkurrencën ose neneve 19 ose 20 të këtij ligji, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të ndihmojë Komisionin Kosovar të Konkurrencës në kryerjen e këtij hetimi dhe vlerësimin shkeljes së pohuar.
4. Komisioni Kosovar i Konkurrencës dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të nënshkruajnë një protokoll i cili përmban dispozita të hollësishme për rregullimin e bashkëpunimit të ndërsjellët për çështjet e përcaktuara në këtë nen.

KREU VII

MASAT E EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN E ENERGJISË

Neni 22

E drejta për kufizimin e furnizimit me energji

1. Qeveria, si masë emergjente, mund të vendosë kufizime në furnizimin me energji për konsumatorët, ose të vendosë obligime të veçanta për ndërmarrjet e energjisë që hyjnë në fuqi gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme të shpallur nga Presidenti në pajtim me Kushtetutën nëse vendosja e kufizimeve të këtilla është e nevojshme dhe e përshtatshme në rrethanat të cilat e arsyetojnë shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe një veprim i këtillë nuk është në kundërshtim me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme ose me ndonjë kufizim të vendosur nga Kuvendi mbi gjendjen e jashtëzakonshme në bazë të autoritetit të Kuvendit sipas Kushtetutës.
2. Qeveria gjithashtu mundet që si masë emergjente të kufizojnë furnizimin me energji për konsumatorët ose të vendosë detyrime të veçanta mbi ndërmarrjet e energjisë në çdo situatë tjetër emergjente, nëse Qeveria vendos se masat emergjente përkitazi me sektorin e energjisë janë të nevojshme, duke përfshirë në situatat në vijim:

2.1. çfarëdo aksidenti material në instalimet për prodhimin, transmisionin apo shpërndarjen e energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror;

2.2. çfarëdo ndërprerje të papritur ose të befasishme afatgjatë të kapacitetit prodhues energjetik ose kapacitetit të transmisionit apo shpërndarjes së energjisë; ose

2.3. çfarëdo aktiviteteve terroriste dhe veprimesh luftarake.

3. Kur Qeveria merr vendimin sipas paragrafit 2. të këtij neni, ajo menjëherë do të lëshojë një vendim me shkrim lidhur me këtë në të cilin përshkruan rrethanat të cilat e arsyetojnë vendimin dhe përcakton kufizimet dhe/ose detyrimet e veçanta të cilat janë vendosur. Qeveria mund ta zbatojë menjëherë këtë vendim dhe i dërgon këtë vendim Kuvendit brenda tri (3) ditëve kalendarike pas lëshimit të vendimit. Brenda shtatë (7) ditëve kalendarike pas pranimit të vendimit, Kuvendi e aprovon ose e refuzon vendimin me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse Qeveria nuk e dërgon vendimin në Kuvend brenda tri (3) ditëve kalendarike pas lëshimit të vendimit ose Kuvendi nuk e aprovon atë vendim brenda shtatë (7) ditëve kalendarike pas pranimit të vendimit, vendimi i Qeverisë pushon se pasuri fuqi ose efekt.

4. Vendimi i marrë nga Qeveria sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni dhe i aprovuar nga Kuvendi do të zgjasë vetëm gjatë kohës së vazhdimit të emergjencës dhe do të ketë kohëzgjatje maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, përveç nëse zgjatet nga Kuvendi. Nëse është e nevojshme vendimi mund të zgjatet me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë për periudha të njëpasnjëshme prej tridhjetë (30) ditëve derisa të arrihet totali prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve shtesë. Pas kësaj periudhe duhet të nxirret një vendim i ri i Qeverisë për emergjencën.

5. Kuvendi mund të vendosë kufizime mbi kohëzgjatjen dhe fushëveprimin e vendimit të Qeverisë të marrë sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni.

6. Në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme sipas paragrafit 1. të këtij neni ose një vendimi sipas paragrafit 3. të këtij neni, Qeveria sipas nevojës dhe në përputhje me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme ose vendimin e lartpërmendur dhe në përputhje me ndonjë kufizim të vendosur nga Kuvendi mund të vendosë masat në vijim për trajtimin e emergjencës përkatëse:

6.1. të vendosë kufizime mbi aktivitetet komerciale që kanë të bëjnë me burime të caktuara të energjisë;

6.2. të vendosë kushte të veçanta komerciale;

6.3. të kufizojë eksportimin dhe importimin e energjisë ose të vendosë kushte të veçanta për eksportimin dhe importimin e energjisë;

6.4. të detyrojë prodhimin e energjisë që do të ndodhë në objekte të saktësuara të prodhimit; dhe

6.5. të vendosë detyrime për furnizimin me energji për konsumatorë të caktuar vetëm në bazë të kriterëve të para-përcaktuara dhe objektive të përpiluara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë; dhe

6.6. mund të përshkruan masa tjera të arsyeshme varësisht nga rrethanat.

7. Ndërmarrjet e energjisë nuk janë të detyruara të paguajnë çfarëdo dëmi të shkaktuar ndaj cilitdo person si rezultat i kufizimeve apo ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, energjisë për ngrohje apo gaz natyror, të vendosura sipas këtij neni 24, me përjashtim të rasteve kur Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka përcaktuar që emergjenca ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së ndërmarrjes së energjisë apo të ndonjë punëtori të saj. Zyra e Rregullatorit për Energji do të krijojë një procedurë për vlerësimin e neglizhencës së këtillë, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga ajo neglizhencë, si dhe për vlerësimin e kompensimit eventual që i duhet paguar konsumatorëve dhe/ose ndërmarrjeve tjera të energjisë. Çdo përcaktim i këtillë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin për procedurën administrative.

KREU VIII
TË DREJTAT PRONËSORE TË NDËRMARRJEVE TË ENERGJISË

Neni 23
Stabilimentet e reja dhe ekzistuese energjetike

Te gjitha stabilimentet e reja dhe ekzistuese për prodhimin, transmisionin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror do të jenë në prona për të cilat ndërmarrja përkatëse e energjisë gëzon të drejtat përkatëse të pronësisë, shfrytëzimit ose qasjes. Linjat dhe tubat për transmisionin dhe shpërndarjen e energjisë mund të kalojnë përmes, mbi, në ose nën çdo pronë vetëm nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë ka një servitut ose të drejtë të shfrytëzimit të pronës ose përkatëse ose servituti apo e drejta e shfrytëzimit i jepet ose merret nga ndërmarrja përkatëse energjetike në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.

Neni 24
Prona e cila aktualisht është në shfrytëzim ose posedim të ndërmarrjeve të energjisë

1. Çdo ndërmarrje e energjisë e cila ka në pronësi, shfrytëzim (ose ka të drejtën e shfrytëzimit), operon ose ka në posedim stabilimente energjetike të vendosura në një pronë për të cilën ndërmarrja e energjisë nuk ka siguruar ose nuk i është dhënë formalisht një servitut, e drejtën e shfrytëzimit ose e drejtën pronësore dhe këto stabilimente energjetike janë në posedim ose shfrytëzim të ndërmarrjes së energjisë me në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, atëherë kjo ndërmarrje do të ketë, përmes veprimit të këtij ligji, të gjitha servitutet, të drejtat e shfrytëzimit dhe/ose të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës përkatëse. Këto servitute, të drejta të shfrytëzimit ose të drejta pronësore u nënshtrohen kushteve të përcaktuara në këtë nen .

2. Prona në të cilën ndodhen stabilimentet energjetike përveç linjave ose tubave të transmisionit dhe shpërndarjes së energjisë do të jepet në shfrytëzim me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve që fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas kësaj të drejte të shfrytëzimit, ndërmarrja përkatëse e energjisë do të ketë të drejtat në vijim:

2.1. posedojë dhe shfrytëzojë pronën përkatëse për çdo qëllim që nuk është i ndaluar sipas ligjin e Kosovës;

2.2. të largojë çdo posedues të jashtëligjshëm nga prona;

2.3. të kompensohet për dëmet e shkaktuara nga një posedues i paligjshëm në të njëjtën shkallë sikurse pronarët e pronave të patundshme në pajtim me ligjin e Kosovës;

2.4. lirisht të shesë, transferojë ose disponojë me të drejtën e shfrytëzimit, ose cilindo aspekt të saj; dhe

2.5. ta ngarkojë të drejtën e shfrytëzimit;

3. Kushtet në vijim gjithashtu do të aplikohen në raport me të drejtën e shfrytëzimit:

3.1. komunat dhe autoritetet tjera publike mund të mbledhin taksat dhe tarifa nga ndërmarrja energjetike në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën shkallë sikurse ndërmarrja energjetike të ishte pronari i pronës;

- 3.2. ndryshimet fizike në pronën përkatëse, duke përfshirë ndërtimet në atë pronë, nuk ndikojnë në fushëveprimin dhe kushtet e të drejtës së shfrytëzimit;
- 3.3. e drejta e shfrytëzimit nuk ndikohet nga ndryshimet e të drejtave pronësore mbi pronën përkatëse;
- 3.4. e drejta e shfrytëzimit mund të shpronësohet vetëm në bazë të kushteve, kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin e Kosovës, duke përfshirë kërkesën për pagimin e kompensimit;
- 3.5. ndërmarrja e energjisë do ta kompensojë në mënyrë të përshtatshme pronarin publik për të drejtën e shfrytëzimit; dhe
- 3.6. kur është e nevojshme, perimetri i pronës përkatëse do të përcaktohet në përputhje me aktet e aplikueshme nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.
4. Të gjitha linjat dhe tubat e transmisionit dhe shpërndarjes së energjisë që kalojnë përmes, mbi, në apo nën një pronë konsiderohet se e kanë të drejtën e servitutit të përhershëm mbi pronën e prekur në favor të ndërmarrjes së energjisë duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Servitutet e lartpërmendura u nënshtrohen standardeve dhe kufizimeve të detyrueshme të përcaktuara në aktet e aplikueshme nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.
5. E drejta e shfrytëzimit ose servituti i krijuar me këtë nen përfshin të drejtën e qasjes nga një rrugë ose autostradë publike në pronën përkatëse përmes pronave të tjera nëse kjo qasje kërkohet nga ndërmarrja përkatëse e energjisë për të siguruar funksionimin e rregullt dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve përkatëse energjetike dhe nëse dhe deri në atë shkallë sa kjo është në përputhje me ligjin e Kosovës dhe ndonjë vendim të aplikueshëm të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.
6. Kur një ndërmarrje e energjisë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka një të drejtë të shfrytëzimit të tokën publike e cila është regjistruar në Zyrën Komunale Kadastrale në emrin e saj ose në emër të një Entiteti Paraardhës, kjo e drejtë e shfrytëzimit – përmes veprimit të këtij ligji – i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në dispozitat paraprake të këtij neni.
7. Të drejtat pronësore të krijuara sipas këtij neni si dhe të drejtat pronësore mbi asetet të dhëna gjatë procesit të inkorporimit të një ndërmarrje të energjisë e cila ka qenë e licencuar në vitin 2006 për operimin e sistemit të shpërndarjes ose transmisionit në Kosovë, menjëherë pas kërkesës së ndërmarrjes përkatëse të energjisë do të regjistrohen në emër të saj në Regjistrin përkatës të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyra përkatëse Kadastrale Komunale. Ky regjistrim do të bëhet pavarësisht ekzistimit apo jo të një kontrate për këtë qëllim ndërmjet ndërmarrjes së energjisë dhe pronarit të regjistruar të pronës, nëse ka një pronar të tillë.
8. Gjatë regjistrimit sipas paragrafit 7. të këtij neni, ndërmarrja përkatëse e energjisë duhet të përfshijë në regjistrin e pronave të paluajtshme një njoftim i cili përshkruan të drejtat dhe kufizimet e përcaktuar në paragrafët 9. dh 10. të këtij neni.
9. Në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 10. të këtij neni, çdo person privat i cili konsideron se të drejtat të cilat i janë dhënë një ndërmarrje të energjisë sipas këtij neni i cenojnë të drejtat e tij/saj pronësore në atë mënyrë që mund të konsiderohet si shpronësim për të cilin duhet të paguhet kompensimi sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në çdo kohë brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve nga data e përbushjes së kushteve të njoftimit për pronën e prekur sipas paragrafit 8 mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës për pagimin e kompensimit nga Qeveria e Kosovës. Qeveria e Kosovës ka të drejtën e rimbursimit ose zhdëmtimit nga ndërmarrja përkatëse e energjisë për çdo kompensim të cilin gjykata kërkohen të paguhet, përveç nëse një kontratë në të cilën Republika e Kosovës është palë shprehimisht përcakton ndryshe. Në rast të vendimit për pagimin e kompensimit, shuma e kompensimit (në ka) do të përcaktohet në përputhje me dispozitat për kompensimin të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me atë ligj.
10. Asnjë kompensim sipas paragrafit 9. të këtij neni nuk do t'i paguhet një personi nëse:

10.1. para datës së dorëzimit të kërkesës për kompensim, të drejtat përkatëse të regjistruara nga ndërmarrja e energjisë janë paguar ose janë realizuar përmes veprimit të një kontrate ose ligji tjetër (p.sh me parashkrim);

10.2. ligji i aplikueshëm në kohën e vendosjes së stabilitmenteve në pronën përkatëse nuk ka kërkuar pagimin e kompensimit;

10.3. ligji i aplikueshëm në kohën e vendosjes së stabilitmenteve në pronën përkatëse ka lejuar kompensimin, mirëpo pronari ose pronarët e prekur, pa ndonjë arsye bindëse dhe të ligjshme, nuk i kanë ushtruar me kohë të drejtat e tyre ligjore për marrjen e kompensimit brenda afateve të aplikueshme ligjore, afate këto që fillojnë në datën në të cilën stabilitmentet së pari janë vendosur në pronën përkatëse; ose

10.4. në kohën e vendosjes së stabilitmenteve në pronën përkatëse, prona ka qenë në pronësi shoqërore ose shtetërore.

Neni 25

Zhvillimet e reja në tokë private

1. Nëse një ndërmarrje e energjisë propozon ndërtimin e stabilitmenteve të reja ose zgjerimin e stabilitmenteve ekzistuese të prodhimit, transmisionit ose shpërndarjes për të cilat nevojitet përvetësimi i servituteve, të drejtave të shfrytëzimit ose të drejtave tjera pronësore në tokë private, ndërmarrja përkatëse e energjisë do ta njoftojë pronarin e tokës private. Në njoftim duhet të përfshihen detalet lidhur me tokën mbi të cilën do të vendoset barra ose e cila do t'i transferohet ndërmarrjes përkatëse të energjisë dhe kompensimin e propozuar në bazë të vlerës së drejtë të tregut të tokës. Të gjitha servitutet ose të drejtat tjera pronësore të pajtuara në mes të palëve duhet të regjistrohen në Zyrën përkatëse Kadastrale Komunale. Me kusht që, të gjitha servitutet do t'u nënshtrohen standardeve dhe kufizimeve të detyrueshme të përcaktuara në ndonjë akt nënligjor të aplikueshëm të aprovuar nga Ministria në bazë të këtij ligji.

2. Nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë dhe pronari i tokës nuk mund të pajtohen mbi nevojën për krijimin ose zgjerimin e servituteve ose mbi kahjen brenda tridhjetë (30) ditëve nga dërgimi i propozimit me shkrim nga ndërmarrja e energjisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndërmarrja e energjisë mund të kërkojë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që të lëshojë një vendim mbi çështjen se nëse stabilitmentet e reja ose të zgjeruara janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të ndërmarrjes së energjisë sipas licencës ose nëse kërkohen sipas ligjeve të Kosovës.

3. Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të lëshojë vendimin e lartpërmendur brenda tridhjetë (30) ditëve nga dorëzimi i kërkesës me shkrim nga ndërmarrja përkatëse e energjisë në formën e përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

4. Nëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë vendos se stabilitmentet e reja ose të zgjeruara janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të ndërmarrjes përkatëse të energjisë sipas licencës, ky vendim konsiderohet se i plotëson kërkesat e nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë do t'ia dërgojë këtë vendim Qeverisë së bashku me një kërkesë të saj për iniciimin e procedurave për shpronësimin e tokës private dhe transferimin e tokës ndërmarrjes së energjisë në këmbim me kompensimin e përcaktuar në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Neni 26

Zhvillimet e reja në tokën publike

1. Nëse një ndërmarrje e energjisë propozon ndërtimin ose zgjerimin e stabilitmenteve të reja ose ekzistuese të prodhimit, transmisionit ose shpërndarjes për të cilat nevojitet krijimi i servituteve, të drejtave të shfrytëzimit ose të drejtave pronësore në tokë publike, ndërmarrja përkatëse e energjisë duhet të njoftojë komunën përkatëse ose autoritetin tjetër publik dhe të kërkojë dhënien e servitutit ose një të drejte tjetër pronësore në bazë të paragrafëve të vijim.

2. Nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë dhe komuna ose autoriteti publik nuk mund të pajtohen mbi nevojën për krijimin ose zgjerimin e servituteve ose të drejtave tjera pronësore brenda tridhjetë (30)

ditëve nga dërgimi i kërkesës me shkrim nga ndërmarrja përkatëse e energjisë për këto servitute ose të drejta pronësore, ndërmarrja e energjisë mund të kërkojë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që të lëshojë një vendim mbi çështjen se nëse këto servitute ose të drejta pronësore janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të ndërmarrjes së energjisë sipas licencës ose nëse kërkojnë sipas ligjeve të Kosovës.

3. Nëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë vendos se servitutet ose të drejtat pronësore janë të nevojshme, ky vendim konsiderohet se i plotëson kërkesat e nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

4. Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të lëshojë vendimin e lartpërmendur brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës me shkrim nga ndërmarrja përkatëse e energjisë në formën e përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

5. Zyra e Rregullatorit të Energjisë do t'ia dërgojë këtë vendim Qeverisë së bashku me një kërkesë të saj për iniciimin e procedurave për shpronësimin e tokës publike dhe transferimin e kësaj toke ndërmarrjes së energjisë kundrejt kompensimit të përshtatshëm. Çdo servitut i krijuar i nënshtrohet standardeve dhe kufizimeve të detyrueshme të përcaktuara në çfarëdo akti nënligjor të aplikueshëm.

6. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e cenon vlefshmërinë e servituteve të cilat i janë dhënë një ndërmarrje të energjisë në bazë të akteve nënligjore të aplikueshme të aprovuara nga Ministria në përputhje me Ligjin e mëparshëm për Energjinë.

Neni 27 Servitutet

1. Ndërmarrjet e energjisë kanë të drejtë të shfrytëzojnë pa pagesë në rast nevojë të arsyeshme disa pjesë të ndërtesave për vendosjen e pajisjeve për matje si dhe pajisjeve të tjera që kanë të bëjnë me shpërndarjen apo furnizimin me energji elektrike, energji të ngrohjes ngrohje dhe gaz natyror.

2. Ndërmarrjet për energji kanë të drejtë të shfrytëzojnë pa pagesë në rast nevojë të arsyeshme urat, rrugët, trotualet dhe ndërtesat e tjera, që nuk janë në pronësi të tyre, për ndërtimin, lidhjen, kalimin dhe mirëmbajtjen e linjave të sipërme dhe tokësore të energjisë elektrike, gypave për ngrohje, gypave të gazit, gypave të ujit.

Neni 28 Inspektimet mirëmbajtja dhe matja

1. Personat fizikë dhe juridikë do të lejojnë zyrtarët që ushtrojnë inspektime në përputhshmëri me këtë ligj, mund të hyjnë dhe të kalojnë në pronën e çfarëdo individi për ushtrimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me inspektimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve energjetike, instalimeve apo sistemeve.

2. Personat fizikë dhe juridikë do t'u lejojnë përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve për energji qasje në pronën e tyre në të cilën gjenden stabilimentet, aparaturat, rrjetat, ose sistemet energjetike në të cilat qasja e tillë është e nevojshme, me qëllim të mirëmbajtjes apo kontrollimit të tyre, prerjes së pemëve ose vegjetacionit tjetër që mund të pengoj veprimin e stabilimenteve, aparaturës, rrjetave ose sistemit.

3. Personat fizikë dhe juridikë duhet t'u lejojnë qasje përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve për energji, për inspektimin e pajisjeve për matje që gjenden në pronën e tyre, në të cilën qasja e tillë është e nevojshme, dhe nuk mund të ndalojnë përfaqësuesit e ndërmarrjeve për energji të bëjnë shkyçjen e pajisjeve për matje ose aparaturave të tjera në lidhje me sistemin e energjisë.

Neni 29 Kompensimi i dëmeve

1. Ndërmarrjet për energji i kompensojnë pronarët ose shfrytëzuesit e pronës për çfarëdo dëmi që mund të shkaktohet gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre që mund të rezultojë në kufizimin e shfrytëzimit të pronës ose zvogëlimin të vlerës së saj.

2. Kriteret dhe kushtet e kompensimit rregullohen me Ligjin për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës.

Neni 30 Zonat e sigurisë

1. Zonat e sigurisë duhet të vendosen përreth zonat energjetike.
2. Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese apo godine, prerja e bimëve ose pemëve, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës dhe pronës.
3. Kushtet dhe mënyra e përcaktimit të lokacionit, madhësia, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimi i tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve përcaktohen me akt nënligjor që miratohet nga Ministria.

Neni 31 Cenimi i zonave të sigurisë

1. Kur pronarët ose shfrytëzuesit e pronës bëjnë ndërtime të palejuara, rrethime, prerje ose aktivitete të tjera që janë në kundërshtim me rregullat për zonat e sigurisë, dhe kur dështojnë përpjekjet për ndalimin e ndërtimeve ose aktiviteteve të tilla ilegale të paautorizuara brenda afateve kohore të vendosura nga ndërmarrjet e energjisë, ndërmarrjet për energji është e autorizuar që të kërkojë nga Komuna ndalimin dhe heqjen e ndërtimeve ilegale ose ndalimin e aktiviteteve, me shpenzime të pronarit ose shfrytëzuesit.
2. Komunitat që pranojnë kërkesa të tilla nga ndërmarrjet e energjisë, brenda shtatë (7) ditëve, kryejnë veprimet e rrënimin e ndërtimit joligjor apo ndalojnë aktivitetin joligjor.

KREU IX MBIKËQYRJA

Neni 32 Mbikëqyrja dhe inspektimi administrativ

1. Mbikëqyrja administrative e zbatimit të këtij ligji dhe legjislacionit përkatës sekondar kryhet nga Ministria.
2. Inspektimet e duhura për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji kryhen nga Inspektorati i Energjisë, si organ që vepron në kuadër të Ministrisë. Inspektorati i Energjisë, nëse konsideron se është e nevojshme, mund të kryen inspektime të stabilimenteve energjetike dhe përgatitë një raport me shkrim mbi inspektimin, një kopje të së cilit do t'ia dërgojë Ministrisë.
3. Nëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë e konsideron si të nevojshme, ajo mund t'i kërkojë Inspektoratit të Energjisë që të kryej inspektime, pa pagesë, të objekteve energjetike dhe t'i sigurojë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë raportin me shkrim mbi inspektimin.
4. Të gjithë personat fizikë ose juridikë që posedojnë ose operojnë stabilimente, pajisje, godina, sisteme ose instalime energjetike, për të cilat sipas këtij ligji parashihet inspektimi, obligohen të informojnë menjëherë inspektoratin e energjisë mbi çfarëdo dëmi ose gabimi që mund të shfaqet si pasojë e ndërprerjes së furnizimit të energjisë, ose nëse ekziston rreziku për jetën, shëndetin e njerëzve, trafikut, godinave fqinje apo mjedisit rrethues.
5. Gjatë inspektimit i cili do të kryhet sipas kushteve të këtij ligji, Inspektorati i Energjisë ka të drejtë në qasje në pajisjet dhe stabilimentet për qëllimet e përshkruara në nën-paragrafët 5.1. deri 5.5. të këtij paragrafi. Të gjitha ndërmarrjet energjetike apo personat tjerë fizikë apo juridikë sigurojnë qasje të tillë nëse një gjë e tillë kërkohet nga përfaqësuesi i autorizuar i Inspektoratit të Energjisë:

5.1. inspektojnë pajisjet, materialet si dhe dokumentacionet teknike të tjera në përputhshmëri me qëllimin e inspektimit ose mbikëqyrjes;

- 5.2. marrin mostra apo kërkojnë sigurimin e provave apo mostrave të nevojshme
 - 5.3. inspektojnë dokumentet apo të dhëna tjera nga ndërmarrjet energjetike apo organizata profesionale ose ekspertë individualë;
 - 5.4. shqyrtojnë shërbimet energjetike në përgjegjësinë e tyre; dhe
 - 5.5. kryejnë inspektime të gjendjes teknike dhe sigurisë së pajisjeve energjetike në bazë të rregullt ose kurdo që kërkohet;
6. Nëse inspektorët e Inspektoratit të Energjisë gjatë inspektimit të tyre mbikëqyrës vërejnë se një ndërmarrjen energjetike apo konsumator i energjisë nuk kryen operacionet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe akteve tjera përkatëse, krahas autorizimeve të përgjithshme me akte të përgjithshme, ata kanë autoritet të nxjerrin vendime me shkrim si në vijim:
- 6.1. të udhëzojë eliminimin e mangësive të konfirmuara brenda një periudhe të caktuar kohore;
 - 6.2. të ndalojë ndërtimin e objekteve të prodhimit, nëse nuk janë siguruar të gjitha lejet e nevojshme për ndërtim;
 - 6.3. të udhëzojë pezullimin e ndërtimit apo shfrytëzimin e mëtutjeshëm të objektit energjetik; apo
 - 6.4. të udhëzojë ndërprerjen e furnizimit të energjisë apo shfrytëzimit të energjisë nëse pajisjet apo objekti nuk është duke prodhuar apo nëse objektet nuk ndërtohen, shfrytëzohen apo mirëmbahen në pajtim me kërkesat teknike të kodeve, rregullave apo legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe nëse ka rrezik të drejtpërdrejtë ndaj objektit energjetik dhe sigurisë së ndërtesës, shëndetit, jetës, sigurisë së qarkullimit dhe sigurisë së ndërtesave fqinje.
7. Nëse, si rrjedhojë e inspektimit, Inspektorati i Energjisë beson se një ndërmarrje energjetike apo një tjetër person fizik apo juridik është në shkelje të këtij ligji, Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Ngrohjen Qendrore, Ligjit për Gazin Natyror, apo Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, apo legjislacionit sekondar të nxjerrë nga cilido nga këta ligje, apo licencave, Inspektorati i Energjisë mund të:
- 7.1. nxjerrë njoftim me shkrim që përmban udhëzime të detyrueshme për korrigjimin e shkeljeve brenda një afati të caktuar;
 - 7.2. t'i propozojë Zyrës për Rregullatorin e Energjisë që të pezullojë, ndryshojë ose tërheqë licencën përkatëse;
 - 7.3. t'i propozojë Zyrës së Rregullatorit për Energji të vendosë gjoba administrative dhe dënime sipas këtij ligji;
 - 7.4. ta dërgojë çështjen para autoriteteve kompetente për të ndërmarrë masa të mëtutjeshme që nuk janë nën mandatin e Inspektoratit; apo
 - 7.5. të informojë publikun mbi çfarëdo veprimtarie ilegale.
8. Aktivitetet e inspektimit të kryera nga Inspektorati i Energjisë nuk parandalojnë apo kufizojnë inspektimet në të gjitha premiset nga autoritetet tjera, kompetencat e të cilave përcaktohen me ligje tjera, veçanërisht përkitazi me inspektimet në lidhje me pajtueshmërinë e ligjeve dhe standardeve mbi mbrojtjen mjedisore dhe shëndetin publik.

Neni 33 Ruajtja e informatave

1. Inspektorët e Inspektoratit të Energjisë duhet të mbajnë të fshehtë çfarëdo informate zyrtare ose afariste që ata e hasin gjatë ushtrimit ose në lidhje me inspektimet e tyre.

2. Inspektorët e Inspektoratit të Energjisë ushtrojnë aktivitetet e tyre vetëm, ose, në rast të nevojës, së bashku me organe të specializuara të kontrollit siç e shohin ata të nevojshme.

KREU X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34 Dispozitat kalimtare

1. Ky ligj shfuqizon dhe zëvendëson Ligjin për Energjinë nr. 2004/8, ndërsa të gjitha aktet, vendimet , rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjit Nr. 2004/8 mbeten të vlefshme nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas ligjit 2004/8 duhet të harmonizohen me këtë ligj.
3. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria nxjerrë akte nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 35 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,

**Ligji Nr. 03/ L-184
7 tetor 2010**

Shpallur me dekretin Nr. DL-058-2010, datë 25.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.